

# **PROTOKOLL**

## **I MENAXHIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË NIVEL VENDOR, PËRMES MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT (MKR)**

## PROTOKOLL

# I MENAXHIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË NIVEL VENDOR, PËRMES MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT (MKR)

**BASHKIA** \_\_\_\_\_

**Miratur nga Komiteti Drejtues  
i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit,**

**Me Nr. Prot.** \_\_\_\_\_ **në mbledhjen e datës** \_\_\_\_\_



Protokolli është përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri” financuar nga Qeveria e Suedisë.

## TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	3
1. QËLLIMI I PROTOKOLLIT DHE BAZA LIGJORE E PËRGATITJES SË TIJ .....	4
2. PËRKUFIZIME .....	5
3. PARIMET E FUNKSIONIMIT TË MKR-SË QË UDHËHEQIN DHE PUNËN PËR MENAXHIMIN E RASTEVE .....	6
4. MENAXHIMI I RASTIT .....	7
4.1. RASTET DHE MËNYRA E MENAXHIMIT TË TYRE .....	7
4.2. HAPAT NË MENAXHIMIN E RASTEVE.....	8
4.3. MENAXHIMI I NJË RASTI EMERGJENT.....	9
4.3.1. ROLI I INSTITUCIONEVE TË TJERA, ANËTARE TË ETN NË MENAXHIMIN E RASTEVE EMERGJENTE .....	14
4.4. MENAXHIMI I NJË RASTI JO EMERGJENT .....	17
4.4.1 ROLI I INSTITUCIONEVE TË TJERA, ANËTARE TË ETN NË MENAXHIMIN E RASTEVE JO EMERGJENTE.....	17
5. REFERENCA.....	22
6. ANEKSE.....	23
ANEKS 1: MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT DHE PËRBËRJA E TIJ.....	23
ANEKS 2: HARTA E SHËRBIMEVE REZIDENCIALE PUBLIKE DHE JO-PUBLIKE TË STREHIMIT EMERGJENT PËR VIKTIMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	25
ANEKS 3: HARTA E SHËRBIMEVE REZIDENCIALE PUBLIKE DHE JO-PUBLIKE TË STREHIMIT AFATGJATË PËR VIKTIMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	27
ANEKS 4: LISTA E SHËRBIMEVE LIGJORE FALAS PRANË GJYKATAVE TË NDRYSHME TË VENDIT.....	28
ANEKS 5: FORMULAR PËR VLERËSIMIN E NEVOJAVE TË RASTIT TË DHF/DHBGJ.....	29
ANEKS 6: MODEL PLANI I NDIHMËS INDIVIDUALE PËR RASTET E MENAXHUARA NGA MKR .....	32
ANEKS 7: FORMULAR TIP PËR REFERIMIN E RASTEVE NDËRMJET ANTARËVE TË MKR .....	37
ANEKS 8: MODEL I RAPORTIT PERIODIK TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË URDRIT TË MBROJTJES.....	38

## HYRJE

Protokoll i Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), është një dokument shumë i rëndësishëm i cili **synon të standardizojë veprimet e nevojshme për t'u kryer nga të gjithë anëtarët e MKR-ve për të siguruar një reagim të menjëhershëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, në përputhje me kompetencat dhe detyrat e tyre ligjore, për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje<sup>1</sup> dhe vënien e dhunues(e)ve përpara përgjegjësisë.**

I fokusuar në kryerjen e veprimeve të nevojshme për menaxhimin efektiv të rasteve të dhunës në familje, ky dokument përmban **veprime të unifikuara për t'u zbatuar konkretisht nga anëtarët e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ETN)**, të cilët kanë përgjegjësinë e trajtimit të rasteve në praktikë. Protokoll i është një mjet praktik që përcakton në mënyrë të thjeshtë e të qartë se si do të ndërveprojnë anëtarët e ETN-së me njëri-tjetrin në fazat e ndryshme të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje. Ai bazohet në fiziolofinë e qasjes shumë-sektoriale të koordinuar që është përshkruar edhe në Marrëveshjen e Bashkëpunimit për formalizimin apo vijimin e punës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, të nënshkruar nga anëtarët përkatës në nivel vendor, bazuar në legjislacionin në fuqi për adresimin e dhunës në familje.

Si i tillë, Protokoll i Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje, pasi të plotësohet me të dhënat konkrete të përbërjes dhe anëtarësisë së MKR-së të ngritur nga bashkia, duhet të kalojë për miratim tek Komiteti Drejtues i MKR-së përkatëse.

Protokoll i Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje u përgatit përmes një procesi të udhëhequr nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të mbështetur nga UNDP Shqipëri, ku u angazhuan specialistet e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore dhe eksperte të fushës<sup>2</sup>.

Zbatimi në praktikë i këtij protokoll i udhëhiqet si nga parimet bazë të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje, ashtu dhe nga parimet bazë të të punuarit përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar duke patur në fokus viktimën.

---

<sup>1</sup> Pavarësisht se në trajtimin e rastit “viktima” është edhe “e mbijetuar”, në Protokoll është përdorur fjala “viktima” në respektim të terminologjisë ligjore.

<sup>2</sup> Znj. Aurela Bozo, znj. Marsela Allmuça dhe znj. Monika Kocaqi, të kontraktuara nga UNDP Shqipëri. Protokoll ka përfituar nga mendimet dhe sugjerimet e ofruara nga Znj. Brunilda Dervishaj, Znj. Irena Benussi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Znj. Edlira Papavangjeli dhe Znj. Elona Dini, UNDP Shqipëri.

# 1. QËLLIMI I PROTOKOLLIT DHE BAZA LIGJORE E PËRGATITJES SË TIJ

**Qëllimi** i Protokollit të Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje është të sigurojë një reagim shumë-sektorial të koordinuar të menjëhershëm dhe efektiv për mbrojtjen, referimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e rasteve të identifikuar, përmes ndërhyrjeve të sakta e të standardizuara të anëtarëve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar, në përputhje me detyrimet dhe rolin e tyre, të përshkruar në legjislacionin në fuqi si dhe në të githë dokumentat e miratuara në funksion të zbatimit të këtij legjislacioni.

Hapat e përshkruar në pjesët në vijim, rekomandohen të ndiqen me kujdes nga të gjithë anëtarët e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të ngritur në nivel vendor me qëllim trajtimin efektiv, të shpejtë dhe të suksesshëm të rasteve të viktimave të dhunës në familje, si dhe vënien përpara përgjegjësisë dhe ndëshkimit në përputhje me legjislacionin në fuqi të dhunues(e)ve.

## Baza Ligjore

Hartimi i këtij Protokollit është mbështetur në një kuadër ligjor ndërkombëtar e kombëtar të përditësuar, ku si më të rëndësishmet përmendim:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë<sup>3</sup>
- Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me Ligjin nr. 104/2012<sup>4</sup>
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)<sup>5</sup>
- Deklarata e vitit 1993 për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave<sup>6</sup>
- Deklarata e Pekinit e vitit 1995 dhe Platforma për Veprim<sup>7</sup>
- Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar
- VKM Nr.334, datë 17.02.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe Ministres së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, Nr. 866, datë 20.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 912, datë 27.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e urdhërit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”, etj.

<sup>3</sup> Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit. Miratuar me referendum më 22.11.1998. Shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani. Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007. Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008. Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.09.2012 Ndryshuar me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015 Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016.

<sup>4</sup>Rregjistruar në faqen e Konventës në datën 04.02.2013

(shiko:<http://www.conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=210&CM=&DF=&CL=ENG>)

<sup>5</sup> Shqipëria e ka ratifikuar këtë konventë në vitin 1993 dhe protokollin e saj shtesë në vitin 2003.

<sup>6</sup> Vendim i Asamblesë së Përgjithshme 48/104.

<sup>7</sup> Raporti i Konferencës së Katërt Botërore për Gratë, Pekin, 4-15 shtator 1995 (Botim i Kombeve të Bashkuara, Nr. i botimit E.96.IV.13), Kapitulli 1, Vendimi 1, Shtojca I dhe Shtojca II

## 2. PËRKUFIZIME

Përkufizimet e listuara në vijim bazohen kryesisht në Ligjin nr.9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar:

- **“Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje”** (MKR) - rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.
- **“Koordinator(ja) Vendor(e) kundër Dhunës në Familje” (KVDHF)** – specialist(e) i(e) emëruar me kohë të plotë në Bashki, me detyrimin dhe përgjegjësinë për të përmbushur detyrat e përcaktuara në VKM nr. 334, datë 17.02.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, të reflektuara edhe në përshkrimin e punës së tij/saj.
- **“Punonjësi i policisë”** – punonjësi i policisë, i cili do të kryejë vlerësimin e riskut dhe procedurat përkatëse për përgatitjen e dosjes për lëshimin e Urdhërit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM). Policia e shtetit është aktor kyç në zbatimin dhe monitorimin e urdhërave të mbrojtjes dhe bashkëpunon ngushtësisht me KVDHF dhe institucionet e tjera anëtare të ETN-së, për menaxhimin me sukses të rastit të dhunës në familje.
- **“Vlerësimi i riskut”** - fazë e menaxhimit të rastit të dhunës në familje, që kryhet në mënyrë të shpejtë, menjëherë pas identifikimit ose raportimit të rastit, me qëllim ndalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm të dhunës dhe mbrojtjen e viktimës përmes Urdhërit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme.
- **“Urdhëri për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme” (UMPMM)** – urdhëri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1, të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.
- **“Urdhëri i Menjëhershëm i Mbrojtjes” (UMM)** – urdhëri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhërit të mbrojtjes me vendim gjykate, në bazë të Ligjit nr. 9669/2006, i ndryshuar.
- **“Urdhër Mbrojtjeje” (UM)** – urdhëri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit, etj., në bazë të Ligjit nr. 9669/2006, i ndryshuar.
- **“Marrëdhënie intime”** - marrëdhënia ndërpersonale që përfshin intimitet fizik ose emocional.
- **“Njësi shtëpiake”** - banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes.
- **“Fëmijë”** - sipas legjislacionit shqiptar, është cilido person nën moshën 18 vjeç.

### 3. PARIMET E FUNKSIONIMIT TË MKR-SË QË UDHËHEQIN DHE PUNËN PËR MENAXHIMIN E RASTEVE

Disa nga parimet themelore<sup>8</sup> ku duhet të mbështeten anëtarët e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor, si dhe KVDHF, në punën dhe veprimtarinë e tyre janë:

- **Konfidencialiteti** i shërbimeve duhet të ruhet patjetër. Jeta private dhe konfidencialiteti i viktimave duhet të ruhet patjetër ashtu sikurse edhe adresat e shërbimeve të cilat kanë në fokus sigurinë e viktimës (strehëzat e emergjencës dhe strehëzat afatgjata për dhunën në familje).
- **Viktima në qendër të sistemit.** Shërbimet duhet të jenë të orientuara për nga viktima-nevojat dhe siguria e viktimave duhet të jenë konsiderata parësore;
- **Vënia e dhunuesit(es) përpara përgjegjësisë.** Dhunuesi(ja) duhet të mbajë përgjegjësi për veprimet e tij(saj). Anëtarët e MKR duhet ta vënë theksin te kjo përgjegjësi dhe ndërhyrjet duhen bërë me synimin që dhunuesi(ja) të mbajë përgjegjësi të plotë dhe të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi;
- **Qëndrueshmëria.** Është shumë e rëndësishme që MKR të ketë qëndrueshmëri, si financiare, ashtu edhe strukturore. Kjo qëndrueshmëri është e domosdoshme edhe kur flitet për përfaqësimin dhe anëtarësinë e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor. Specialistet(ët) e deleguar(a) nga institucionet antare të MKR për të qenë pjesë e ETN duhet të kenë qëndrueshmëri. Kjo përgjegjësi duhet të bëhet pjesë e përkrahjeve të tyre të punës dhe koha e shpenzuar për menaxhimin e rasteve, pjesëmarrjen në mbledhjet përkatëse mujore, apo edhe për çdo aktivitet tjetër në funksion të ETN duhet t'u njihet dhe vlerësohet si kohë pune.
- **Siguria.** Çdo plan veprimi që diskutohet si zgjidhje e situatës së viktimave, duhet patjetër të ketë si faktor kryesor sigurinë e tyre. Për shembull, burimet dhe mbështetja e krijuar për viktimat nuk duhet të paraqesë barriera, qoftë edhe të paqëllimshme, dhe nga ana tjetër, nuk duhet të komprometojë sigurinë e tyre. Gjithmonë, kur hartohen protokollat ose trajtohen rastet e dhunës në familje, duhen ngritur pyetje se cilat lloje ndërhyrjesh funksionojnë dhe se çfarë mund të verë në rrezik apo të rrisë sigurinë e viktimës. Planet e sigurisë së viktimave është mirë që të përgatiten paralelisht me kryerjen e procesit të vlerësimit të riskut.
- **Zgjerimi i reagimit.** Një rol i rëndësishëm i MKR-së është edhe ai i përmirësimit të vazhdueshëm të trajtimit të rastit si dhe zgjerimit të burimeve që u ofrohen viktimave të dhunës në familje. Pas krijimit të grupit të anëtarëve dhe hartimit të protokolleve dhe procedurave, Komiteti Drejtues duhet të organizojë mbledhje të rregullta për të diskutuar mbi ecurinë dhe mënyrën e të punuarit të ETN-së. Këto diskutime duhet të përqendrohen te procedurat e ndjekura që nga pika e parë e kontaktit me viktimën deri në hapat e ardhshme të menaxhimit të rastit.

<sup>8</sup> Parimet e veprimtarisë së MKR-së janë pjesë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit "Për ngritjen e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR)"

## 4. MENAXHIMI I RASTIT

Menaxhimi i rastit është një proces, apo mënyrë e organizimit dhe kryerjes së punës për të adresuar nevojat e një të rrituri(e) apo fëmije (dhe familjes së tyre) në kohën e duhur, në mënyrë të përshtatshme e sistematike, përmes mbështetjes direkte dhe / ose referimeve, si dhe në përputhje me objektivat e institucionit /organizatës/ Mekanizmit. Thënë ndryshe, menaxhimi i rastit është një shërbim për identifikimin e nevojave si dhe koordinim shërbimesh për plotësimin e këtyre nevojave. Në tërësinë e këtij procesi, një punonjës(e) vlerëson së bashku me viktimën se për çfarë shërbimesh ka nevojë, sigurohet që këto shërbime përfitohen dhe monitoron rregullisht ofrimin e tyre. Menaxhimi i rastit siguron hap pas hapi ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për individët në nevojë (fëmijë, e/i rritur apo familje) dhe synon të promovojë dhe nxitë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e personit.

### 4.1. RASTET DHE MËNYRA E MENAXHIMIT TË TYRE

Të gjitha rastet e dhunës në familje që paraqiten dhe kërkojnë ndihmë, në cilindo prej institucioneve anëtare të MKR-së (apo në cilindo prej anëtarëve të ETN-së të listuar në aneksin 1 të këtij Protokolli), duhet të trajtohen në mënyrë të menjëhershme, me efektivitet dhe duke u ofruar shërbime shumë-disiplinare.

Pavarësisht se cila është pika e parë e kontaktit nga ana e viktimës, anëtarët e ETN-së duhet të bashkëpunojnë menjëherë dhe në varësi të nevojave të rastit, duke u dhënë prioritet nevojave më emergjente. Përfaqësuesi(ja) i(e) secilit institucion pjesë e ETN-së që kontaktohet për herë të parë nga viktima, ka detyrimin të njoftojë KVDHF dhe policinë (pra personat e cituar në aneksin 1 të këtij Protokolli në kontaktet e shënuara aty) me qëllim mbërritjen e tyre në vendngjarje, për kryerjen e vlerësimit të riskut dhe trajtimin e menjëhershëm të rastit, sipas detyrave që përcakton Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, për secilin autoritet përgjegjës. Njëkohësisht me njoftimin, përfaqësuesi(ja) i(e) institucionit të parë pritës<sup>9</sup> duhet të fillojë menjëherë procedurat e trajtimit të rastit duke u bazuar në rregullat, detyrimet dhe përgjegjësitë e institucionit që përfaqëson.

Policia dhe KVDHF përcaktojnë se cilët anëtarë të tjerë të ETN-së dhe cilat burime nevojiten për ndërhyrjen e parë dhe/ose të menjëhershme dhe duhet të njoftojnë menjëherë një “ekip bërthamë” për të trajtuar nevojat emergjente të rastit. KVDHF siguron burime ose e referon rastin në shërbime të tjera të specializuara për viktimat e dhunës në familje, të cilat kanë nevojë për strehim emergjent apo afatgjatë, ndihmë ligjore falas, këshillim psikologjik, trajtim mjekësor dhe të tjera mbështetje të nevojshme.

KVDHF së bashku me ekipin bërthamë i cili trajton nevojat emergjente të rastit, pas dhënies së ndihmës së parë viktimës së dhunës në familje thërret mbledhjen e ETN-së për trajtimin afatgjatë të rastit dhe shërben si ndërmjetës(e) me OJF-të, policinë, shërbimet shëndetësore, gjykatat, shërbimet sociale, dhe institucione/organizata të tjera ofruese shërbimesh, për të dhënë informacion, për t’i referuar viktimat tek shërbimet për të cilat kanë nevojë, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre.

Për rastet të cilat nuk kërkojnë ndërhyrje emergjente, institucionet/organizatat njoftojnë KVDHF duke plotësuar formularin TIP për referimin e rasteve (Aneks 7), ndërkohë që më pas KVDHF shtron rastin për shqyrtim në mbledhjen e ETN.

<sup>9</sup> Nënkupton institucionin/organizatën e parë që kontaktohet



## 4.2. HAPAT NË MENAXHIMIN E RASTEVE

Në kontekstin e punës në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, ky proces kalon në disa hapa/faza të rëndësishme, si në vijim:

**Së pari:** Identifikimi dhe/ose raportimi i rastit. Personi i dhunuar mund të vendosë të denoncojë në polici, tek KVDHF ose në çdo institution tjetër të parashikuar në ligj. Institucione të caktuara mund të identifikojnë rastin si rast të dhunës në familje pavarësisht nëse është denoncuar dhuna prej viktimës apo jo. Për rastet që kërkojnë ndërhyrje emergjente, kur jeta e viktimës është në rrezik të lartë, institucioni në të cilin është drejtuar viktimja ka detyrimin të njoftojë KVDHF, me qëllim mbërritjen e tij/saj së bashku me policinë në vendngjarje dhe trajtimin e menjëhershëm të rastit të dhunuar. Kjo është një fazë e rëndësishme që vijon me vënien në lëvizje të policisë, KVDHF dhe anëtarëve të tjerë të ETN-së.

**Së dyti:** Vlerësimi i riskut dhe përgatitja e raportit. Punonjësi Policisë së Shtetit ngarkuar për kryerjen e vlerësimit të riskut njofton KVDHF, i(e) cili(a) mund të asistojë në procesin e kryerjes së vlerësimit të riskut, si dhe në përgatitjen nga ana e punonjësit të policisë së raportit përkatës mbi vlerësimin e riskut. Nëse KVDHF nuk ka mundësi për t'u paraqitur menjëherë sapo merr njoftimin, mund të shikohet zëvendësimi i tij(saj) nga një punonjës(e) social(e) i(e) Drejtorisë/Zyrës për shërbimet shoqërore në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Në rast të mosparaqitjes në kohë të KVDHF / punonjësit(es) social(e) të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësinë e vetëqeverisjes vendore, punonjës i policisë vijon me vlerësimin e riskut dhe hartimin e raportit pa vonesë. Raporti i vlerësimit të riskut përcakton nivelin e rrezikut për rastin dhe sugjeron në proporcion me rrezikun, një ose disa nga masat e parashikuara në Ligjin nr. 9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar. Në rastin e fëmijëve viktimja të dhunës në familje, policia merr në mbrojtje fëmijën dhe referon rastin pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki (NJMF)/ Punonjësit(es) për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në njësinë administrative të Bashkisë dhe harton raportin e vlerësimit të riskut patjetër në prani të përfaqësuesit(es) të NJMF/PMF. Në rastin e fëmijëve që kanë asistuar në skena dhune në familje, policia njofton KVDHF dhe kërkon domodoshmërisht praninë e përfaqësuesit të NJMF/PMF gjatë vlerësimit të riskut dhe hartimit të raportit.

**Së treti:** Menaxhimi i rrezikut. Menaxhimi i rrezikut mund të përfshijë miratimin nga Shefi i Komisarariatit të Policisë të urdhërit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, marrjen e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, vendosjen e viktimës në një qendër rezidenciale emergjente ose afatgjatë, vendosjen e viktimës pranë qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale, zbatimin e UMPMM-së, marrjen edhe të masave të tjera të nevojshme për menaxhimin e riskut dhe zbatimin e UMPMM-së, të cilat koordinohen me institucionet përkatëse nga KVDHF dhe anëtarët e tjerë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje; vlerësimin e masave në gjykatë dhe lëshimin e UMM/UM, zbatimin e UMM/UM, ndjekjen penale të dhunuesit, etj. Pjesë e rëndësishme e menaxhimit të riskut është edhe hartimi i planit individual të ndërhyrjes (shih aneksin nr.6), i cili mbështetet në vlerësimin e nevojave të identifikuar dhe shërbimet për përmbushjen e tyre dhe hartohet nga KVDHF në bashkëpunim me anëtarët e MKR. Vendosja e viktimës në një qendër rezidenciale emergjente ose afatgjatë do të kryhet në rastet kur paraqitet e domodoshme për shkak të riskut për jetën e saj, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve të mitur për të mos qëndruar me dhunuesin/en në mënyrë të pa mbikëqyrur, vullnetin e viktimës për t'u strehuar, si dhe legjislacionin në fuqi për standardet dhe procedurat për pranimin në këto qendra.

**Së katërti:** Monitorimi i rastit. KVDHF bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të policisë së shtetit për monitorimin e zbatimit të masave të UMPMM-së. Gjatë kohëzgjatjes së vendimit

gjyqësor për UMM/UM-në, policia mban kontakte të vazhdueshme me KVDHF dhe zyrën e shërbimeve sociale në bashki, e cila monitoron respektimin e urdhrat të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë. Raporti i monitorimit të zbatimit të masave të UMM/UM përgatitet i veçantë për çdo rast dhe për sa herë kryhet monitorimi përgjatë gjithë kohëzgjatjes së UMM/UM-së, sipas një formati tip (shih bashkëlidhur aneksin nr.8). Kur nga monitorimi i zyrës së shërbimeve sociale në bashki, rezultojnë kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj<sup>10</sup>, njoftohet menjëherë policia pa prituri përmbushjen e afatit 60 ditor të përgatitjes së raportit. Monitorimi i rastit përfshin gjithashtu edhe ndjekjen e progresit në përmbushjen e planit individual të ndërhyrjes (shih bashkëlidhur aneks 6) mbi shërbimet e planifikuara për viktimën, pra nëse po i përfiton këto shërbime, apo dhe ndikimin që ato kanë pasur në rehabilitimin apo ri-integrimin e rastit.

**Së pesti: Vlerësimi dhe mbyllja e rastit.** Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (ETN) pas monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm, kur e konsideron se janë përbushur të gjitha veprimet e planifikuara për ndjekjen e një rasti dhe secili institucion ka kryer me përgjegjshmëri detyrimet e tij, vendos mbylljen e rastit. Në mbylljen e rastit, ETN vlerëson me kujdes situatën e viktimës, nëse viktimja ka përfituar shërbimet që i nevojiten, nëse pas këtyre shërbimeve të vazhdueshme është kaluar trauma e dhunës së përjetuar, nëse është ulur apo minimizuar niveli i riskut, etj. Vendimi për mbylljen e rastit merret kur:

- ndërhyrjet e ndërmarra e kanë reduktuar nivelin e rrezikut, në rrezik të ulët ose mungesë rreziku;
- gjatë monitorimit të vazhdueshëm nuk kanë rezultuar rrethana ose fakte që rasti mund të kthehet në situatën e mëparshme të dhunës siç mund të jenë p.sh. shkelje të masave specifike të UM-së nga dhunuesi, pamundësi e ri-interimit të viktimës (për shkaqe të lidhura me mungesën e strehimit, punësimin, etj).
- nëse si rezultat i shërbimeve dhe mbështetjes së ofruar rezultojnë se është kapërcyer trauma e dhunës me të cilën është përballur viktimja;
- rasti zhvendoset në një zonë tjetër dhe referohet për ndjekje tek KVDHF/ ETN e asaj zone, pasi është bashkëpunuar për dhënien e informacionit të nevojshëm dhe për çdo nevojë tjetër nga KVDHF/ ETN e vendbanimit të përhershëm.
- rasti humbet jetën/vdes.

Rastet me rrezik të ulët mbyllet nga KVDHF vetëm pasi, pas përfundimit të shërbimeve të ofruara, kryhet edhe një tjetër vlerësim, bazuar në rezultatet e të cilit anëtarët e ETN-së dhe profesionistët(et) të cilat/cilët kanë ofruar shërbime për rastin, bien dakord për mbylljen e tij.

#### 4.3. MENAXHIMI I NJË RASTI EMERGJENT

Rasti, në të cilin nga kryerja e vlerësimit të riskut rezultojnë se dhuna e ushtruar paraqet nivel të lartë të rrezikut për jetën, shëndetin, mirëqenien dhe lirinë e anëtarëve të familjes, konsiderohet si **rast emergjent** për t'u menaxhuar. Një rast i tillë kërkon nga strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, marrjen menjëherë të masave paraprake të mbrojtjes së viktimave për ndalimin e dhunës apo përshkallëzimit të mëtejshëm të saj, si dhe mbrojtjen dhe sigurinë e jetës.

<sup>10</sup> Pra, kur p.sh. gjykata ka urdhëruar në Urdhërin e mbrojtjes të ndalojë menjëherë të paditurin/en (dhunuesin/en) që t'i afrohet vendit të punës së viktimës, ose shtëpisë apo banesës së familjes së origjinës ku viktimja po qëndron, dhe dhunuesi/ja i është afëruar vendit të punës ose banesës së viktimës apo banesës së familjes së origjinës, njoftohet menjëherë policia.

Në menaxhimin e një rasti emergjent<sup>11</sup> duhet të përfshihet “ekipi bërthamë”, me qëllim që të jepet një zgjidhje sa më e shpejtë dhe efektive dhe në përmbushje të nevojave emergjente të rastit.

Nëse **policia** është pika e parë e kontaktit, si në rastin kur viktimja (apo një i afërm, ose komshi, apo kalimtar) kërkon ndihmë (apo denoncon) nëpërmjet telefonit, ashtu dhe kur viktimja paraqitet direkt në ambjentet e policisë, anëtarët e ETN ndjekin hapat e mëposhtëm:

- Punonjësi i policisë mbërrin në vendngjarje/merr takim me viktimën e dhunës në familje (dëgjon në mënyrë të hollësishme çfarë ka ndodhur, merr në shënim të dhënata e viktimës, kqyr vendngjarjen dhe mbledh/dokumenton prova të mundshme nëse është rasti, plotëson formularët dhe raportet përkatëse për intervistimin/pritjen e viktimës, sipas kërkesave që ka institucioni, i ofron viktimës informacion mbi ligjin për dhunën në familje, etj). Ndërkohë, pavarësisht nëse është duke shkuar për në vendngjarje apo nëse e takon viktimën në ambjentet e policisë, njofton menjëherë KVDHF dhe kërkon praninë e tij/saj për të filluar me procesin e vlerësimit të riskut. Kur nga njoftimi për ndihmë nëpërmjet telefonit merret informacion mbi dëmtime të mundshme shëndetësore të viktimës apo anëtarëve të tjerë të familjes, njoftohet paralelisht edhe qendra shëndetësore/spitali, me qëllim që të mbërrijë edhe ambulanca sa më parë në vendngjarje, në rast nevojë për ndërhyrje të menjëhershme dhe trajtim të kushteve shëndetësore të viktimës apo familjarëve. Në rastin kur edhe fëmijët janë viktimja të dhunës së drejtpërdrejtë në familje, menjëherë pas marrjes në mbrojtje të fëmijës dhe referimit të rastit pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki / Punonjësit(es) për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë administrative të Bashkisë, struktura përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit harton raportin e vlerësimit të riskut edhe në prani të përfaqësuesit(es) të NJMF / PMF në njësinë administrative të Bashkisë. Kur nëna është drejtuar në ambientet e policisë pa marrë me vete fëmijët dhe ajo deklaron se fëmijët kanë asistuar në skena dhune, referohet rasti menjëherë pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki / Punonjësit(es) për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë administrative të Bashkisë, me qëllim kryerjen e vlerësimit të riskut në prani të psikologut/es, vlerësimin e nevojave të fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme.
- Punonjësi i policisë i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit të riskut njofton KVDHF ose në pamundësi të tij/saj një punonjës/e social/e të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësinë e vetëqeverisjes vendore, si dhe në rastin kur janë fëmijë prezent njofton gjithashtu PMF e njësisë vendore, me qëllim që ta asistojnë në hartimin e raportit të vlerësimit të riskut për rastin e dhunës në familje. Njoftimi nga policia i KVDHF/punonjësit(es) social(e), si dhe NJMF/PMF kur viktimja është fëmijë është i detyrueshëm. KVDHF mund të asistojë në hartimin e raportit të vlerësimit të riskut për rastin e dhunës në familje, pasi njoftohet nga punonjësi i Policisë së Shtetit i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit të riskut.  
Nëse KVDHF ose punonjësi/ja social/e nuk paraqiten në kohë, punonjësi i policisë kryen pa vonesë vlerësimin e riskut dhe hartimin e raportit, nëse bëhet fjalë vetëm për viktimë të rritur. Ndërsa në rastin e viktimës së mitur, prania e NJMF/PMF është domosdoshmëri dhe procesi i vlerësimit të riskut kryhet në përputhje me Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, si dhe të VKM nr. 578/2018 “Për procedurat e referimit e të

<sup>11</sup> Anëtarët e ETN bien dakort që si “rast emergjent” do të konsiderohet rasti i vlerësuar nga policia dhe/ose KVDHF dhe/ose punonjësja sociale e bashkisë si rast me risk të lartë

menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

- Nëse vendi ku është identifikuar ose raportuar rasti i dhunës në familje është i ndryshëm nga ai i vendbanimit të viktimës ose dhunuesit(es), punonjësi i policisë mund të kërkojë informacion nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit të vendbanimit të tyre, me qëllim kryerjen e vlerësimit të riskut.
- Punonjësi i policisë në bashkëpunim me KVDHF/punonjësen sociale dhe PMF kur bëhet fjalë për fëmijët kryen vlerësimin e riskut me shpejtësi, bazuar në informacionin që disponohet si rezultat i identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës, si dhe të informacioneve të tjera që mund të mblidhen menjëherë nga pyetja e viktimës, e dhunuesit ose e anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe nga institucionet, organizatat ose individët, që kanë dijeni për rastin.
- Punonjësi i policisë, pasi ka analizuar informacionin harton raportin e vlerësimit të riskut, sipas formatit të miratuar me Udhëzimin e përbashkët, nr. 866, datë 20.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”. Këtë raport ia paraqet titullarit të strukturës vendore të policisë, duke sugjeruar a) miratimin e urdhërit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nëse është rasti, si dhe b) marrjen e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme të parashikuara në ligj dhe në udhëzimet e përbashkëta. **Masat mbrojtëse lëshohen në pajtim me nivelin e riskut.**
- Punonjësi i policisë në hartimin e raportit për vlerësimin e riskut respekton aneksin, pjesë përbërëse e udhëzimit përkatës të sapocituar.
- Titullari i strukturës vendore të policisë lëshon UMPMM dhe plotëson kërkesën për vleftësimin e masave të UMPMM-së dhe lëshimin e UMM-së. Ai paraqet kërkesën tip për vlerësimin/konfirmimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme pranë gjykatës së rrethit gjyqësor brenda 48 orëve nga hyrja në fuqi e UMPMM-së.
- Kur nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, strukturat përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit, marrin menjëherë masa paraprake të mbrojtjes së viktimave dhe për ndalimin e dhunës. (Neni 13/1, pika 2, ligji nr.9669, datë 19.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar).
- Policia merr pjesë aktive në procesin e hartimit të planit individual të ndërhyrjes nga punonjësi(ja) social(e) ose KVDHF. Kontributi konsiston në përcaktimin e masave të nevojshme për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi dhe minimizimin e pasojave të dhunës.
- Policia bashkëpunon me njësinë e vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave për veçimin e dhunuesit(es) nga familja.
- Një kopje e urdhërit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme i njoftohet menjëherë nga policia Koordinatorit(es) Vendor(e) kundër dhunës në familje.
- Kërkesë padinë e plotësuar për lëshimin e UMM, punonjësi i policisë e dërgon në Gjykatën e rrethit dhe për çdo rast kontakton me përfaqësuesen(in) e gjykatës.

- Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit dhe/ose KVDHF, paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime nëse thirren nga gjykata në procesin e vlerësimit të UMPMM. KVDHF asiston viktimat me informacion mbi njohjen e të drejtave të tyre, në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe për hapat që duhen ndjekur nëse urdhëri shkelet.
- Në rast nevoje, punonjësi i policisë bën shoqërimin e viktimës në Spital.
- Punonjësi i policisë duhet të mbështetet edhe nga KVDHF, i(e) cili(a) ka detyrim ligjor shoqërimin e viktimës në gjykatë, polici apo shërbime të tjera<sup>12</sup>. KVDHF mund të shoqërojë viktimën/të mbijetuarën në Spital apo në ndonjë nga institucionet e tjera të cituara, gjithmonë nëse Policia vlerëson që është shmangur rreziku dhe që viktimë mund të lëvizë edhe vetëm me praninë e KVDHF.

**\*Kur paraqitet e domosdoshme për shkak të riskut për jetën e viktimës**, punonjësi i policisë i sugjeron titullarit të strukturës së policisë **vendosjen e viktimës në një qendër rezidenciale publike apo jo-publike emergjente ose afatgjatë**. Në këtë rast punonjësi i policisë mban parasysht interesin më të lartë të fëmijëve të mitur për të mos qëndruar me dhunuesin/en në mënyrë të pambikëqyrrur, vullnetin e viktimës për t'u strehuar, si dhe legjislacionin në fuqi për standardet dhe procedurat për pranimin në këto qendra. Punonjësi i policisë lidhet me Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, ose strehëza të tjera emergjente apo afatgjata. Kontaktet e këtyre qendrave gjenden në Aneksin 2 dhe 3 të këtij Protokoll. Punonjësi i policisë duhet të mbështetet me informacionin e nevojshëm edhe nga KVDHF për vendosjen e viktimës në një strehëz, emergjente ose afatgjatë. Gjithashtu duhet të shqyrtohen alternativat sa më pranë vendbanimit të viktimës (strehizat emergjente apo afatgjata) dhe në mungesë të mbështetjes nga ana e tyre, strehizat në Tiranë (publike apo jo-publike).

Në rastin kur në respektim të vullnetit të viktimës dhe interesit më të lartë të të miturve viktimë strehohet pranë familjarëve të saj, ose një banesë të dytë në një qytet tjetër, policia monitoron rastin e dhunës në familje duke garantuar sigurinë e përfitueses dhe/ose të familjarëve të saj. Në rast se viktimë e dhunës në familje strehohet në një banesë në një qytet tjetër, njoftohen menjëherë strukturat përkatëse të policisë si edhe KVDHF për monitorimin e rastit dhe garantimin e sigurisë së viktimës, fëmijëve në varësi dhe familjarëve/të afërmve ku po strehohet.

**\*Kur rasti i përket një viktime të dhunës seksuale**, punonjësi i policisë në bashkëpunim me KVDHF dhe /ose NJMF/PMF kur flitet për të mitur, referon rastin për t'u trajtuar pranë **Qendrës së Menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale "LILIUM"**.

**Nëse nevojiten shërbime avokatie**, atëherë punonjësi i policisë dhe KVDHF kontakton me OJF-të e specializuara në ofrimin e këtyre shërbimeve, ose me zyrën përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë apo edhe me Zyra Avokatie Falas, siç paraqiten në Aneksin 4 të këtij Protokoll. Këto qendra operojnë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Në rastet kur nuk ka qendra të tilla, sugjerohet të kontaktohen ofrues shërbimesh të ndihmes ligjore falas siç mund të jenë klinikat universitare.

Punonjësi i policisë duhet të mbështetet edhe nga **KVDHF** dhe të referohet në listën e përditësuar të kontakteve në aneksin 4 të këtij protokoll, për të mundësuar referimin e viktimës

<sup>12</sup> Shih VKM nr.334/datë 17.02.2011.

në shërbimet e nevojshme ligjore. KVDHF duhet të përgatisë dhe përditësojë vazhdimisht një listë me kontakte me të gjithë profesionistët dhe shërbimet e vlefshme, ku mund të referohet rasti. KVDHF ndan listën me të gjithë anëtarët e MKR dhe e afishon atë në vende të dukshme në ambientet e bashkisë si dhe në zyrën e tij/saj. KVDHF sigurohet të marrë një kopje të listës me vehte sa herë që shkon në komisariatit e policisë ose të takojë viktimën në banesë gjatë monitorimit të zbatimit të urdhrave të mbrojtjes, ose në raste të tjera (pra në varësi të rastit dhe procedurave të ndjekjes së tij). KVDHF e përditëson periodikisht këtë listë.

Nëse nevojiten **shërbime shëndetësore**, pra nëse nga dhuna e ushtruar viktimat ka dëmtime në shëndet duhet patjetër të adresohet në njësinë vendore të kujdesit shëndetësor apo në spitalin më të afërt për të marrë shërbimet shëndetësore që i nevojiten (ndërkohë që kryhen veprimet e tjera për lëshimin e UMPMM-së). Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor ose në spitalin më të afërt, viktimat kryen vizitën, merr trajtimin e nevojshëm mjekësor, mbështetje psikologjike dhe pajiset me raportin mjekësor, i cili përbën një provë të rëndësishme gjatë procesit të kërkimit të lëshimit të urdhrave të mbrojtjes.

**Nëse nevojiten shërbime psikologjike**, atëherë punonjësi i policisë dhe KVDHF kontaktojnë me psikologët e bashkisë, shkollave ose OJF-ve, apo dhe me Urdhërin e Psikologut, për të siguruar shërbimin e kërkuar.

Hapa të tjerë që ndërmerr policia:

- Punonjësi i policisë plotëson kërkesën për ekzaminimin mjeko-ligjor dhe ndërkohë lidhet me mjekun ligjor për t'i referuar rastin, sipas të dhënave të paraqitura në aneksin 1 të këtij protokoll
- Kallëzimin penal<sup>13</sup> që ka marrë nga viktimat, punonjësi i policisë ia referon Prokurorisë, duke u bazuar tek të dhënat në seksionin 3.2 të këtij Protokoll
- Ndërkohë, në varësi të rastit, punonjësi i policisë merr kontakt edhe me dhunuesin(en) dhe ndjek procedurat përkatëse sipas rastit (e izolojnë nga viktimat dhe familja, e marrin në pyetje, plotësojnë raportet përkatëse, etj).

Menaxhimi i rastit përfshin zbatimin e UMPMM dhe urdhrave të tjerë mbrojtës.

- Policia në bashkëpunim me KVDHF të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse zbaton UMPMM-në.
- KVDHF koordinohet me institucionet anëtare të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje për marrjen e masave të nevojshme e të përshtatshme për menaxhimin e riskut dhe zbatimin e UMPMM-së.
- Policia ka detyrimin të informojë viktimën e dhunës në familje në lidhje me masat që parashikon UMPMM-ja.
- Policia ka detyrë të informojë personin ndaj të cilit është dhënë urdhëri, në lidhje me masat që parashikon UMPMM-ja dhe detyrimin e tij për ta zbatuar vullnetarisht. Në rastin e mosekzekutimit vullnetar nga dhunuesi(ja), policia e evidenton këtë fakt në kërkesën që i drejton gjykatës KOMPETENTE për vlerësimin e UMPMM-së.

---

<sup>13</sup> Lëshimi i UMPMM-së nuk pengon ndjekjen penale të dhunuesit, nëse është rasti.

- Nëse vendi i raportimit të dhunës është i ndryshëm nga vendi i banimit të anëtarëve të familjes ku ka ndodhur dhuna, zbatimi i UMPMM-së kryhet nga struktura përgjegjëse, që ka nxjerrë urdhërin në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse në vendin e banimit, si dhe me KVDHF-të e vendbanimit dhe vendqëndrimit (pra KVDHF e vendqëndrimit bashkëpunon me KVDHF e vendbanimit).
- Policia, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, ekzekutojnë menjëherë vendimin e UMM të lëshuar nga gjykata, **i cili përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet.**
- Policia, gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM, mban kontakte të vazhdueshme me KVDHF dhe zyrën e shërbimeve sociale në bashki.
- Policia mban kontakte të vazhdueshme me shërbimin e provës, për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor. Kur evidentohen shkelje të kushteve, shërbimi i provës dërgon informacion tek prokurori mbi situatën dhe informacioni referohet edhe tek KVDHF, i cili e ndan me anëtarët e ETN.
- Në rast të mosekzekutimit vullnetar të vendimit nga palët, ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhërat e mbrojtjes. Organet ligjzbatuese, anëtare të MKR zbatojnë detyrimet ligjore në lidhje me ndëshkueshmërinë e autorëve. Lëshimi i UMPMM, UMM/UM nuk pengon ndjekjen penale të rasteve.

#### *4.3.1. ROLI I INSTITUCIONEVE TË TJERA, ANËTARE TË ETN NË MENAXHIMIN E RASTEVE EMERGJENTE*

**4.3.1.1. DAR/Zyra Vendore Arsimore.** Nëse rasti i dhunës në familje është i/e mitur, policia dhe KVDHF njoftojnë menjëherë Zyrën Vendore Arsimore dhe DAR.

**Kjo zyrë merr masat si më poshtë:**

- I përgjigjet menjëherë thirrjes së policisë dhe KVDHF, nëse është përcaktuar prej tyre si anëtar përgjegjës për trajtimin e menjëhershëm të rastit;
- Kontribuon në bashkëpunim me KVDHF në përmbushjen e nevojave emergjente të rastit si p.sh. njoftimi menjëherë i psikologes së shkollës dhe/ose njoftimi i psikologes së një OJF-je dhe/ose psikologes së Urdhrit të Psikologut;
- Vë në dijeni menjëherë drejtuesit e shkollës që ndjekin fëmijët, në lidhje me masat e parashikuara për mbrojtjen e tyre dhe rolin/përgjegjësitë e shkollës;
- Nëse viktimat e dhunës paraqiten në fillim në Zyrën Vendore Arsimore/DAR, DAR/ZVA ka detyrimin të njoftojë KVDHF (duke e shoqëruar edhe me formularin TIP bashkëlidhur në aneksin 7 të këtij protokoll), me qëllim mbërritjen e tij/saj së bashku me policinë në vendngjarje dhe trajtimin e menjëhershëm të rastit.

#### **4.3.1.2. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Spitali Rajonal dhe Qendrat Shëndetësore**

- I përgjigjet menjëherë thirrjes së policisë dhe/ose KVDHF, nëse janë përcaktuar prej tyre si institucion përgjegjës i domosdoshëm për përmbushjen e nevojave emergjente të rastit;

- Sigurojnë që viktimat e dhunës në familje të marrë menjëherë ndihmën mjekësore cilësore në shërbimet e urgjencës ose në familje;
- Sigurojnë ofrimin e ndihmës psikologjike për rastin, kur është nevoja, duke shfrytëzuar burimet e tyre ose duke bashkëpunuar me KVDHF i/e cili/a ndërmjetëson ofrimin e shërbimit psikologjik;
- Pajisin viktimën me raportin mjekësor përkatës;
- Ruajnë konfidencialitetin dhe etikën gjatë trajtimit urgjent të rastit;
- Venë në dispozicion të viktimave dokumentacionin mbi lëndimet;
- I venë në dispozicion raportet përkatëse policisë dhe/ose gjykatës; Këto raporte do t'i shërbejnë policisë në vlerësimin e riskut dhe gjykatës në vlefësimin e masave të UMPMM të lëshuar nga struktura e policisë ose në shqyrtimin e kërkesave për UMM.

#### 4.3.1.3. Mjeku Ligjor

- I përgjigjet menjëherë thirrjes së policisë dhe KVDHF për menaxhimin e rastit emergjent;
- Kryen ekzaminimin e menjëhershëm të rastit të dhunës në familje.
- Nëse konstaton nevoja specifike të viktimave të dhunës, si për ndihmë psikologjike, trajtim të mëtejshëm shëndetësor, etj., vë në dijeni menjëherë KVDHF dhe përmes tij/saj “ekipin bërthamë” të ETN;

#### 4.3.1.4. Zyra e Përmbarrimit

- Bashkëpunon menjëherë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës të UMM me strukturat e Policisë së Shtetit dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;
- Merr pjesë në mbledhjen e ETN për trajtimin e rastit dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me zbatimin e UMM; Përfaqësuesi i Zyrës së Përmbarrimit që merr pjesë në mbledhjen e ETN ndan informacion mbi rastin me përmbarruesin gjyqësor që ndjek zbatimin e UMM për këtë rast;
- Vë në dijeni menjëherë policinë, në rast të mosekzekutimit vullnetar të UMM nga palët; Në të njëjtën kohë informon edhe KVDHF;
- Kërkon ndihmën dhe bashkëpunimin me organet përkatëse (polici, prokurori) në rast konstatimi të vështirësive në zbatim të UMM apo në rast shkeljeje të tyre.

#### 4.3.1.5. Gjykata

- Vlerëson UMPMM e lëshuar nga struktura e Policisë së Shtetit;
- Lëshon UMM për viktimën/at e dhunës në familje;
- Disponon informacion të përditësuar për qendrat rezidenciale që ofrojnë akomodim për viktimat e dhunës në familje dhe/ose fëmijët e tyre, si dhe për shërbimin e këshillimit të burrave dhe djemve, për referimin aty të dhunuesve;
- 48 orë nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos: a) vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhërin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes; b) anulimin e urdhërit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndërprerjen e pasojave të tij, nëse nuk provohen faktet dhe rrethanat për të cilat është lëshuar.
- Gjykata, për nevoja të gjykimit, thërret përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose KVDHF për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime;



- Garanton sigurinë në gjykatë, mos cenimin fizik apo verbal të viktimës në ambientet e gjykatës gjatë proceseve për çështjet me objekt vlerësimin e UMPMM, lëshimit të UMM dhe vërtetimit të UMM.
- Parashikon masa mbrojtëse kryesisht, në urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes për fëmijët të cilët kanë pësuar dhunë ose kanë asistuar në skena dhune;
- Mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

#### **4.3.1.6. Prokuroria. Për rastet që kërkojnë ndërhyrje emergjente:**

- Ushtron ndjekjen penale kur është përpara veprave të dhunës në familje dhe/ose shkeljes së UMM;
- Ndihmon viktimën/at me informacionin e nevojshëm në lidhje me prezantimin e akuzave penale për dhunën në familje, mënyrën e depozitimit të akuzave penale, dokumentacionin që nevojitet, si dhe për veprimet që duhet të kryejnë në vijim përmes koordinatores mbi të drejtat e viktimave në këtë institucion; Koordinatorja mbi të drejtat e viktimave në këtë institucion asiston viktimat nëpërmjet një materiali të përgatitur dhe printuar.
- Mund të paraqesë në gjykatën e rrethit gjyqësor kërkesë për UM dhe UMM për viktimat të rritur dhe të mitur.

#### **4.3.1.7. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror**

- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, e përcaktuar si anëtare përgjegjëse për menaxhimin e menjëhershëm të rastit emergjent, ndan informacion mbi shërbimet e vlefshme sa më afër vendbanimit apo vendqëndrimin të viktimës së dhunës në familje, duke konsideruar moshën e viktimës/ave, numrin e fëmijëve, moshën e fëmijëve, etj.;
- Mbështet policinë dhe KVDHF me punonjës/e social/e dhe/ose specialistë të tjerë;
- Nëse rasti është paraqitur pranë këtij institucioni ose është identifikuar prej tij referohet menjëherë tek policia dhe KVDHF (shoqëruar me formularin TIP).

#### **4.3.1.8. Dhoma e Avokatisë**

- Ofron ndihmë juridike për rastin, nëse është përcaktuar nga KVDHF dhe policia si anëtar përgjegjës i ETN i nevojshëm për t'u përfshirë menjëherë në menaxhimin e rastit emergjent të dhunës në familje.

#### **4.3.1.9. OJF-të**

- Ofrojnë shërbime të menjëhershme për të përmbushur nevojat emergjente të viktimës së dhunës në familje;
- I përgjigjen menjëherë thirrjes së policisë dhe/ose KVDHF, kur janë përcaktuar prej tyre si aktorë përgjegjës për t'u përfshirë menjëherë në menaxhimin e rastit emergjent.

Edhe në trajtimin e rastit emergjent ka një fazë të dytë trajtimi në lidhje me nevojat më afatgjata, ku KVDHF kërkon edhe ndihmën e institucioneve të tjera të tilla si Zyrrat Vendore të Punësimit, institucione apo organizata të fokusuar tek edukimi dhe formimi profesional, etj. KVDHF informon ETN në mbledhjen e rradhës për menaxhimin e rastit emergjent nga ekipi bërthamë i ETN sipas nevojave të identikuara dhe kërkon angazhimin e anëtarëve të tjerë për plotësimin e nevojave më afatgjata dhe rishikimin e planit individual të trajtimit të rastit emergjent, bazuar edhe në adresimin e nevojave afatgjata.

#### **4.4. MENAXHIMI I NJË RASTI JO EMERGJENT**

Menaxhimi i rasteve jo emergjente u lë kohë anëtarëve të ETN-së të diskutojnë dhe të vendosin se si do procedojnë në lidhje me menaxhimin e rastit.

Në rastet jo emergjente, mënyra e informimit të viktimës dhe krijimi i besimit, janë pika kyçe për përcaktimin e planit individual të ndërhyrjes/planit të sigurisë së viktimave (shih aneksin nr.6). Kështu që, me të marrë dijeni për një rast jo-emergjent, KVDHF duhet të fillojë kontaktimin me këtë rast, duke kërkuar edhe ndihmën dhe mbështetjen e institucioneve anëtare të MKR, sipas nevojës.

Pasi njoftohet nga institucioni pritës, ose nga policia e njoftuar nga një institucion pritës, për një rast dhune në familje, KVDHF kryen hapat si më poshtë:

- Në bashkëpunim me policinë mbërrijnë në vendngjarje (nëse njoftimi është me telefon) ose takohen në ambientet e institucionit pritës, për kryerjen e vlerësimit të riskut dhe trajtimin e rastit.
- KVDHF, së bashku me përfaqësuesin e policisë, bëjnë analizën paraprake të ngjarjes që përfshin: një intervistë kokë më kokë me viktimën, me dhunuesin, si dhe me anëtarë të tjerë të familjes, vlerësim të nivelit të dhunës, dokumentim të fakteve dhe plotësimin e formularit standard.
- Kur vlerësohet se rastet nuk kërkojnë ndërhyrje emergjente, KVDHF shtron rastin për shqyrtim në mbledhjen e radhës së ETN.
- KVDHF asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhëri të mbrojtjes, si dhe për hapat që duhen ndjekur nëse urdhëri shkelet.
- KVDHF siguron burime mbështetëse ose shërbime ku duhet të referohet viktimat dhe fëmijët e saj kur është rasti, duke shërbyer si ndërmjetës(e) me OJF-të, policinë, shërbimet shëndetësore, gjykatat, shërbimet sociale, dhe institucione/organizata të tjera ofruese shërbimesh, për të dhënë informacion për t'i ndërmjetësuar viktimat tek shërbimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre

#### **4.4.1 ROLI I INSTITUCIONEVE TË TJERA, ANËTARE TË ETN NË MENAXHIMIN E RASTEVE JO EMERGJENTE**

##### **4.4.1.1. DAR/Zyra Vendore Arsimore**

Nëse rasti i dhunës në familje ndaj fëmijëve nuk është urgjent, kjo zyrë merr masat si më poshtë:

- Një person përgjegjës nga DAR/ZVA dhe shkolla ku mësojnë fëmijët merr pjesë në mbledhjen e ETN për trajtimin e rastit dhe shkëmbimin e informacionit; Personi përgjegjës ndan informacionin e nevojshëm me drejtuesin(in) e shkollës që ndjekin fëmijët dhe mësuesin(in) kujdestar.
- Përbush nevojat afatgjata të rastit të fëmijës së dhunuar si ofrimi për një kohë të caktuar i mbështetjes psikologjike falas nga psikologjia e shkollës. Bashkëpunon me anëtarët e tjerë të ETN për ndjekjen e rastit si Zyra e Shërbimeve Sociale në bashki, policia, etj.;

- Nëse rasti pajiset me urdhër mbrojtjeje njoftohet menjëherë drejtuesi i shkollës që ndjekin fëmijët me qëllim njohjen me masat e urdhëruara dhe mbështetjen për zbatimin e tyre;
- Nëse në vendim janë marrë masa që kufizojnë takimet e të miturve me prindin dhunues ose që detyrojnë dhunuesin të mos i afrohet shkollës njoftohet menjëherë drejtuesi i shkollës i cili njofton mësuesen/in kujdestar dhe personelin e ruajtjes së shkollës me qëllim kujdesin për zbatimin e këtyre masave të UM. Në rast të veprimeve të dhunuesit për të thyer masat e vendosura në vendim, njoftohet menjëherë policia dhe KVDHF në bashki;
- Zyra Arsimore Vendore merr informacion nga drejtuesit e shkollës në lidhje me monitorimin e rastit të të miturit të pajisur me urdhër mbrojtjeje dhe ndan informacionin me KVDHF, i/e cili/a më pas e ndan këtë informacion me ETN në mënyrë të përmbledhur;
- Ndan informacion mbi rastin në mbledhjet e ETN duke shtruar edhe çështjen e nevojave të përditësuara të rastit dhe shërbimeve të nevojshme, si dhe referimin e rastit;
- Kontribuon në hartimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje.
- Mer përsipër angazhimin për të kontribuar në përmbushjen e planit të përbashkët të ndërhyrjes sipas nevojave të rastit.

#### **4.4.1.2. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Spitali Rajonal dhe Qendrat Shëndetësore**

- Një person përgjegjës merr pjesë në mbledhjen e ETN për trajtimin e rastit dhe shkëmbimin e informacionit mbi hapat e marra prej këtij/këtyre institucioni/eve. Sigurojnë për rastin ndihmën mjekësore në familje, të mjekut të familjes dhe në qendrat shëndetësore pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;
- Ofrojnë në çdo kohë ndihmë mjekësore, si dhe sociale e psikologjike për viktimën e dhunës në familje përmes bashkëpunimit me KVDHF dhe ETN;
- Marrin masa që viktima të bëjë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;
- Evidentojnë rastin e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Pajisin viktimën me raportin mjekësor përkatës;
- Referojnë dhe orientojnë viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje;
- Vënë në dispozicion të gjykatës së rrethit gjyqësor raportet përkatëse. Këto raporte do të vlejnë gjykatës në marrjen e vendimit mbi lëshimin e UM;
- Referojnë rastin, nëse nevojitet, pranë qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale;
- Lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) të provave shkresore në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës.
- Kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje.

#### **4.4.1.3. Shërbimi i Provës**

- Një person përgjegjës merr pjesë në mbledhjen e ETN për trajtimin e rastit dhe shkëmbimin e informacionit mbi ecurinë e zbatimit të vendimeve të gjykatës. Nëse rasti është ndjekur penalisht dhe ndaj tij ka një vendim të formës së prerë nga gjykata penale,

personi përgjegjës ndan me anëtarët e ETN informacion mbi ecurinë e zbatimit të këtij vendimi, paraqitjen e të dënuarit/ës pranë shërbimit të provës, moskryerjen e veprave të tjera penale apo detyrime të tjera të përcaktuara nga gjykata penale në vendim. Personi përgjegjës që merr pjesë në mbledhjet e ETN ndan informacionin e marrë për rastin me përfaqësuesin e shërbimit të provës, përgjegjës për ndjekjen e vendimit për rastin.

- Bashkëpunon me njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe anëtarët përgjegjës të ETN. Kur nga monitorimi rezulton shkelje e kushteve, shërbimi i provës dërgon informacion tek prokurori dhe ndan këtë informacion me KVDHF.
- Zbaton legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.
- Kontribuon në hartimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje.

#### **4.4.1.4. Mjeku Ligjor**

- Merr pjesë sipas mundësisë në mbledhjen e ETN, thirrur nga KVDHF për trajtimin e rastit;
- Kontribuon në hartimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje.

#### **4.4.1.5 Zyra e Përmbaramit**

- Bashkëpunon menjëherë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës të UM me strukturat e Policisë së Shtetit dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;
- Merr pjesë në mbledhjet e ETN për trajtimin e rastit dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me zbatimin e UM;
- Përfaqësuesi i Zyrës së Përmbaramit që merr pjesë në mbledhjet e ETN ndan informacion mbi rastin me përmbaramuesin gjyqësor që ndjek zbatimin e UM për rastin;
- Vë në dijeni menjëherë policinë, në rast të mosekzekutimit vullnetar të UM nga palët; Në të njëjtën kohë informohet edhe KVDHF;
- Kërkon ndihmën dhe bashkëpunimin me organet përkatëse (polici, prokurori) në rast konstatimi të vështirësive në zbatim të UM apo në rast shkeljeje të tyre;
- Kontribuon në hartimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje;
- Në rast se gjykata ka vendosur detyrime të ndryshme ushqimore për fëmijët në vendimin e zgjidhjes së martesës dhe atë të lëshimit të UM, Zyra e Përmbaramit zbaton vendimin më të favorshëm, apo në interesin më të lartë për fëmijët.

#### **4.4.1.6. Gjykata**

- Lëshon UM për viktimat e dhunës në familje duke respektuar afatet e gjykimit dhe konsideruar sigurinë e viktimave të dhunës në familje;
- Disponon informacion të përditësuar për shërbimet ekzistuese për viktimat e dhunës në familje dhe programet për rehabilitimin e dhunuesve. Këtë informacion mund ta marrë nga KVDHF dhe ta ndajë me gjyqtaret/ët e gjykatës së rrethit gjyqësor;
- Garanton sigurinë në gjykatë, mos cenimin fizik apo verbal të viktimës në ambientet e gjykatës. Përfaqësuesi i Gjykatës mund të kërkojë nga anëtarët e ETN kur është rasti shoqërimin e rastit nga policia dhe KVDHF në gjykatë;
- Gjykata, për nevoja të gjykimit, thërret përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose KVDHF për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të paraqiten në seancë

gjyqësore për të dhënë shpjegime;

- Në rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit të parashikuar në këtë pikë, si dhe në çdo rast tjetër kur gjykata çmon se plotësimi i kërkesës mund të bëhet shkak për vonesa, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të viktimës, gjykata urdhëron dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës publike, që e disponojnë atë.
- Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet, kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara.
- Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate, u dërgon nga një kopje të tij a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim; b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë; c) zyrës së shërbimeve sociale të njërive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim; ç) komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.
- Parashikon masa mbrojtëse kryesisht, në urdhrin e mbrojtjes për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë asistuar në skena dhune;
- Mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;
- Një person përgjegjës përfaqësues i gjykatës merr pjesë në mbledhjet e ETN dhe merr e ndan informacion në lidhje me rastin;
- Nëse gjykata e rrethit gjyqësor përfaqësohet nga kancelarja, apo një gjyqtar apo një person tjetër përgjegjës në mbledhjet e ETN, informacioni i përmbledhur mbi diskutimin e rastit në mbledhjen e ETN ndahet edhe me gjyqtarin e çështjes;
- Përfaqësuesi i Gjykatës në ETN kontribuon në hartimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje.
- Gjykata penale zbaton legjislacionin penal kundër dhunës në familje për veprime apo mosveprime që përbëjnë figura të veprave penale, kur viktimat ka përdorur për mbrojtje legjislacionin civil dhe penal njëherësh. Personi përgjegjës i gjykatës që merr pjesë në mbledhjet e ETN ndan informacion në lidhje me vendimin penal.

#### **4.4.1.7. Prokuroria**

- Një person përgjegjës merr pjesë në mbledhjet e ETN për trajtimin e rastit;
- Personi përgjegjës nga prokuroria e rrethit gjyqësor ndan sa e lejon ligji informacion me anëtarët e ETN;
- Ofron mbështetje për rastin përmes koordinatores për të drejtat e viktimave në Prokurori;
- Ndhmon viktimën/at me informacionin e nevojshëm në lidhje me prezantimin e akuzave penale për dhunën në familje, mënyrën e depozitimit të akuzave penale, dokumentacionin që nevojitet, si dhe për veprimet që duhet të kryejnë në vijim;
- Nëse Prokuroria përfaqësohet nga koordinatores e të drejtave të viktimave apo një prokuror në mbledhjet e ETN apo një person tjetër përgjegjës, informacioni i përmbledhur mbi trajtimin e rastit në mbledhjen e ETN ndahet me prokurorin e çështjes;
- Kontribuon në hartimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje.

#### **4.4.1.8. Zyra Vendore e Punës**

- Një person përgjegjës merr pjesë në mbledhjet e ETN. Personi përgjegjës ndan

informacionin me personin përkatës në Zyrën Vendore të punës me qëllim përmbushjen e nevojave të rastit për ndjekjen e programeve të formimit profesional dhe punësimit, duke e trajtuar rastin me prioritet;

- Ndjek në vijimësi nevojat e rastit nga ndjekja e programeve të formimit profesional në punësimin e mundshëm të rastit;
- Kur rasti paraqitet për herë të parë të Zyra Vendore e Punës, referon rastin menjëherë pranë policisë dhe KVDHF;
- Kontribuon në hartimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje.

#### **4.4.1.9. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror**

- Një person përgjegjës merr pjesë në mbledhjen e ETN për trajtimin e rastit; Informacioni ndahet me stafin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror për përmbushjen afatgjatë të nevojave të rastit deri në mbylljen e rastit;
- Referon rastin në institucione rezidenciale ose qendrat pritëse publike e jo-publike;
- Asiston në përgatitjen e dosjes përkatëse të rastit duke koordinuar me qendrat që ofrojnë këto shërbime;
- Kontribuon në hartimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje.

#### **4.4.1.10. Dhoma e Avokatisë**

- Ofron ndihmë juridike dytësore për rastin përmes avokatëve nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;
- Merr pjesë në mbledhjet e ETN. Personi përgjegjës që merr pjesë në mbledhjen e ETN për trajtimin e rastit e ndan informacionin me Kryetarin e DHA, me qëllim mbështetjen afatgjatë të rastit;
- Ndan informacion me anëtarët e ETN mbi ecurinë e urdhrave të mbrojtjes së lëshuar, ecurinë e proceseve gjyqësore dhe vendimet e marra nga gjykata e rrethit gjyqësor civile dhe/ose penale;
- Kontribuon në hartimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje.

#### **4.4.1.11 OJF-të**

- Marrin pjesë në mbledhjen e ETN;
- Ofrojnë shërbime afatgjata për rastin bazuar në nevojat e rastit;
- Bashkëpunojnë me të gjithë institucionet anëtare të ETN gjatë menaxhimit afatgjatë të rastit dhe ruajnë konfidencialitetin e rasteve dhe etikën gjatë trajtimit të viktimave të dhunës në familje;
- Kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e një plani të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar të dhunës në familje.

## 5. REFERENCA

- Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;
- VKM nr.334, datë 17.02.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”;
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Brendëshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 866, datë 20.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”;
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Brendëshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 912, datë 27.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme”;
- Udhëzim i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 816, datë 27.11.2018, “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale”.

## 6. ANEKSE

### ANEKS 1: MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT DHE PËRBËRJA E TIJ

#### Lista e anëtarëve të KD dhe ETN<sup>14</sup>

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, Bashkia \_\_\_\_\_ ka formalizuar në \_\_\_\_\_ (datë/muaj/vit) ngritjen e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, përmes nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes institucioneve partnere në nivel vendor.

MKR në Bashkinë \_\_\_\_\_ përbëhet nga tre hallka kryesore:

**1. Komiteti Drejtues (KD)**<sup>15</sup>, i cili drejtohet nga Kryetari(ja) i(e) Bashkisë dhe përbëhet nga titullarët e \_\_\_\_\_ institucioneve të tjera anëtare të MKR si më poshtë:

1. Z/znj \_\_\_\_\_
2. Z/znj \_\_\_\_\_
3. Z/znj \_\_\_\_\_
4. Z/znj \_\_\_\_\_
5. Z/znj \_\_\_\_\_
6. Z/znj \_\_\_\_\_
7. Z/znj \_\_\_\_\_
8. Z/znj \_\_\_\_\_
9. Z/znj \_\_\_\_\_
10. Z/znj \_\_\_\_\_
11. Z/znj \_\_\_\_\_
12. Z/znj \_\_\_\_\_

**2. Ekipi Teknik Ndërdisciplinar**, përcaktohet me vendim të Komitetit Drejtues. Anëtarët e ETN janë përfaqësues teknikë të institucioneve, specialist/e të cilët punojnë drejtëpërdrejt me rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, në institucionet anëtare të MKR-së. Siç parashikohet edhe në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nëshkruar në datën e sipërcituar (në nenin 5 të saj), të gjithë antarët e MKR-së i venë në dispozicion Bashkisë emrin dhe kontaktet e personit të caktuar si anëtar i ETN-së.

ETN e MKR-së në Bashkinë \_\_\_\_\_ konkretisht përbëhet nga<sup>16</sup>:

1. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_
2. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_
3. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_
4. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_
5. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_
6. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_
7. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_
8. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_
9. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_

<sup>14</sup> Kur në përbërjen e Komitetit Drejtues apo ETN ka ndryshim të anëtarëve, ndryshon vetëm ky aneks, i cili pasi përditësohet me kontaktet e përfaqësuesve të rinj, miratohet me Vendim të Komitetit Drejtues të MKR dhe i bashkëlidhet këtij protokoll si Aneks 6.1/1; 6.1/2, etj.

<sup>15</sup> Përpara paraqitjes për miratim në mbledhjen e Komitetit Drejtues, Bashkia duhet të plotësojë të gjithë informacionin mbi KD (emrat e anëtarëve, pozicionet e tyre dhe institucionet që përfaqësojnë)

<sup>16</sup> Përpara paraqitjes për miratim në mbledhjen e Komitetit Drejtues, Bashkia duhet të plotësojë të gjithë informacionin mbi ETN (emrat e anëtarëve, pozicionet e tyre dhe institucionet që përfaqësojnë)




10. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_  
11. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_  
12. Z/znj \_\_\_\_\_ përfaqësues(e) i(e) \_\_\_\_\_

**3. Koordinator(ja) Vendor(e) kundër Dhunës në Familje (KVDHF)**, i(e) cili(a) është një specialist(e) me kohë të plotë, emëruar nga Bashkia në këtë pozicion që prej \_\_\_\_\_ (data/muaji/viti).

Në këtë pozicion është Z/Znj. \_\_\_\_\_ i(e) cili(a) mund të kontaktohet nëpërmjet telefonit nëpërmjet Nr: +355 ..... ose adresës së e-mailit:  
\_\_\_\_\_

## ANEKS 2: HARTA E SHËRBIMEVE REZIDENCIALE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE TË STREHIMIT EMERGJENT PËR VIKTIMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

**Qendrat rezidenciale emergjente publike dhe jopublike (strehëzat emergjente) që ofrojnë shërbime 24 – 72 orë, për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje**




- Qendra të menaxhuara nga bashkitë: Përmet, Pogradec, Roskovec, Sarandë, Urë Vajguore, Krujë
- Qendra të menaxhuara nga organizata të shoqërisë civile (OJF): Shkodër, Korçë, Elbasan, Vlorë
- Qendra të menaxhuara nga bashkia dhe OJF: Dibër
- Qendra LILIUM e menaxhuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: Tiranë

### **Kontakte:**

- **Bashkia Pogradec:** Koordinator Vendor kundër Dhunës në Familje - Arbi Basho, Tel: +355 673810099; Email: [arbibasho@yahoo.it](mailto:arbibasho@yahoo.it)
- **Bashkia Roskovec:** Nertila Pelivani, Koorditore Vendore kundër Dhunes në Familje Tel: +355 682314530; Email: [nertilapelivani2019@gmail.com](mailto:nertilapelivani2019@gmail.com)
- **Bashkia Përmet:** Koorditore Vendore kundër Dhunës në Familje - Arjana Papapano. Tel: +355 692288617; Email: [Papapanoarjana@yahoo.com](mailto:Papapanoarjana@yahoo.com)
- **Bashkia Urë Vajguore:** Menaxhere e Qendrës - Nerita Heqimi, Tel: +355 692617915; Email: [neritaheqimi@yahoo.com](mailto:neritaheqimi@yahoo.com)
- **Bashkia Sarandë:** Koorditore Vendore kundër Dhunes në Familje - Emanuela Cetri. Tel: +355 692609325; Email: [elacetri@yahoo.com](mailto:elacetri@yahoo.com)
- **Bashkia Krujë:** Drejtore e shërbimeve Sociale në Bashki - Ilira Suta, Tel: +355 695147292; Email: [ilira.suta@yahoo.com](mailto:ilira.suta@yahoo.com)
- **Shkodër:** Organizata - Gruaja te Gruaja; Tel: +355 222 411 54 / +355 693310172; Email: [info@gruajatekgruaja.org](mailto:info@gruajatekgruaja.org)
- **Tiranë:** Qendra LILUM, Tel: +355 69307959; Email: [qendra.lilium@qsut.gov.al](mailto:qendra.lilium@qsut.gov.al)
- **Tiranë:** Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS. Tel: +355692542130 Email: [initiative.arsis@gmail.com](mailto:initiative.arsis@gmail.com)
- **Elbasan:** Forumi i Gruas Elbasan: Tel: 0696511674 ; Email: [forumigruaselbasan1991@gmail.com](mailto:forumigruaselbasan1991@gmail.com)
- **Vlorë:** Qendra Psiko - Sociale "Vatra", Tel: +355 33 22 40 78 /+ 355 698884613; Email: [info@qendravatra.org.al](mailto:info@qendravatra.org.al)
- **Dibër:** Agritra Vision – Bukurie Begu, Tel: +355 685574600; Email: [bukuriebegu1@yahoo.com](mailto:bukuriebegu1@yahoo.com)
- **Korçë:** Jezus Krishti për Ballkan, Tel: +355 698454748.

### ANEKS 3: HARTA E SHËRBIMEVE REZIDENCIALE PUBLIKE DHE JO-PUBLIKE TË STREHIMIT AFATGJATË PËR VIKTIMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

#### Qendrat rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime afatgjata, për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje



## **Kontakte:**

### ➤ **Tiranë:**

- Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje; Tel: +355695500895
- Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara, Tiranë; [Tel: +355 042261885/](tel:+355042261885) + 355 692070031; E-mail: [sawg.albania@gmail.com](mailto:sawg.albania@gmail.com)
- Qendra Kombetare Pritëse e viktimave të Trafikimit; Tel: +355692649181
- Qendra Të ndryshëm dhe të Barabartë, Email: [different&equal@icc-al.org](mailto:different&equal@icc-al.org)
- Tel: 0696308188
- Streha LGBTI; Tel: +355699839189; Email: [sos@strehalgbt.al](mailto:sos@strehalgbt.al)  
[info@strehalgbt.al](mailto:info@strehalgbt.al) [ndihme@strehalgbt.al](mailto:ndihme@strehalgbt.al);

➤ **Shkodër:** Komuniteti Papa Xhovanni XXIII; Tel: +355 682142650

➤ **Vlorë:** Qendra Psiko - Sociale "Vatra, Tel: +355 33 224078 /+ 355 698884613;  
Email: [info@qendravatra.org.al](mailto:info@qendravatra.org.al);

➤ **Elbasan:** Tjetër Vizion Tel: +355 692030201                      Email: [tjetervizion@gmail.com](mailto:tjetervizion@gmail.com)

## **ANEKS 4: LISTA E SHËRBIMEVE LIGJORE FALAS PRANË GJYKATAVE TË NDRYSHME TË VENDIT**

### **Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ofrojnë shërbime ligjore falas:**

Av. Alketa Kajmaku, Durrës, +355 694785340

Av. Sonila Shehu, Durrës, +355 685827370

### **Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ofron shërbim ligjor falas:**

Av. Tonin Marku, Shkodër, +355 692044346

**Në Tiranë,** avokatet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, në numrin: +355 672754655

### **ADRF pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier:**

Av. Inva Malaj; +355 699169196

Av. Hektor Hoxha; +355 694653032

**Në Dibër,** TLAS, Av. Fadil Begu +355 068 20 12 028

**Në Lezhë,** TLAS, Nr. i telefonit +355 69 74 20 906

## ANEKS 5 – FORMULAR PËR VLERËSIMIN E NEVOJAVE TË RASTIT TË DHF/DHBGJ

Ky formular vlerësimi plotësohet nga KVDHF bazuar në procesin e vlerësimit të nevojave të rastit të dhunës, në bashkëpunim me anëtarët e MKR/ETN-së me të cilët po menaxhohet rasti. Ai përdoret për të regjistruar dhe analizuar informacionin e marrë përgjatë vlerësimit të rastit (duke përfshirë edhe informacionin e mbledhur përgjatë vlerësimit të riskut) apo çdo informacioni tjetër mbi rastin, i cili ndihmon për identifikimin e nevojave të viktimës së dhunës dhe/ose fëmijëve të saj dhe i paraprin procesit të hartimit të Planit Individual të trajtimit të rastit. Ky formular i shërben KVDHF edhe për të përcaktuar “ekipin bërthamë” që do të nevojitet për përmbushjen e nevojave emergjente të viktimës së dhunës. Formulari shpërndahet paraprakisht tek Ekipi Teknik Ndërdisciplinar në mbledhjen që do të zhvillohet për diskutimin e rastit dhe hartimin e Planit Individual të rastit. Pjesë të caktuara të formularit mund të plotësohen apo qartësohen edhe më mirë gjatë takimit të ETN-së, i cili synon të identifikojë të gjitha nevojat e rastit me qëllim angazhimin e institucioneve përgjegjëse për përmbushjen e tyre.

<b>FORMULAR I VLERËSIMIT TË NEVOJAVE TË RASTIT NGA KVDHF dhe ETN-ja</b>	
Emri i viktimës:	Referenca e Identitetit:
Mosha / Data e Lindjes:	Gjinia:
Data kur është plotësuar Vlerësimi i nevojave:	Vlerësimi i nevojave është bërë (përfshini të gjithë antarët e ETN-së të përfshirë në këtë proces) nga:
Përbërja e rastit / nëse ka fëmijë ose jo:	Adresa e vendbanimit aktual të viktimës
<b>MËNYRA E IDENTIFIKIMIT TË RASTIT</b> (përkruhet si ka ardhur rasti në ETN, nga është referuar)	
<b>SFONDI SITUATËS/</b> Përmbledhje e historive të fundit/ histori të mëparshme/ ngjarje kritike (Për këtë seksion mund t’i referoheni edhe raportit të vlerësimit të riskut, çdo burim të përdorur për vlerësimin e riskut si dhe çdo të dhënë tjetër në dispozicion):	

**NEVOJAT EMERGJENTE TË VIKTIMËS**

**Nevoja për siguri:**

**Nevoja për strehim emergjent:**

**Nevoja për transport të sigurtë:**

**Nevoja për mbështetje psikologjike për viktimën:**

**Nevoja për mbështetje psikologjike për fëmijët e viktimës:**

**Nevoja për shërbim ligjor për lëshimin e UMM:**

**Nevoja për paketë ushqimore dhe/ose ndihma të tjera:**

**Nevoja për trajtim mjekësor:**

**Nevoja për të shoqëruar viktimën për të marrë sendet personale nga banesa për vehte ose fëmijët:**

**Nevoja të tjera:**

**Bazuar në sa më sipër, “Ekipi bërthamë” i ETN do të përbëhet nga:**

**Nevojat jo-emergjente do të diskutohen në mbledhjen e rradhës së ETN:**

**NEVOJAT PËR SIGURI/mbrojtje në vazhdim të rastit:**

**NEVOJAT PËR AKOMODIM AFATGJATË:**

**NEVOJAT PËR MBËSHTETJE PSIKOLOGJIKE:**

<p><b>NEVOJAT PËR MBËSHTETJE/NDIHMË LIGJORE:</b>          Specifiko:          Ndhmë ligjore parësore:          Ndhmë ligjore dytësore:          Objekti i çështjes:</p>
<p><b>NEVOJAT SHËNDETËSORE</b></p>
<p><b>NEVOJA PËR TRANSPORTIMIN E VIKTIMËS PRANË SHËRBIMEVE DHE/OSE INSTITUCIONEVE</b></p>
<p><b>NEVOJAT PËR FORMIM PROFESIONAL/PUNËSIM</b></p>
<p><b>NEVOJAT PËR ARSIMIM (përfshirë fëmijët kur është rasti):</b></p>
<p><b>NEVOJAT PËR NDIHMË EKONOMIKE TË VIKTIMËS:</b></p>
<p><b>MBËSHTETJA FAMILJARE E VIKTIMËS<sup>17</sup>:</b></p>
<p><b>KËNDVËSHTRIMET / DËSHIRAT E VIKTIMËS:</b></p>
<p><b>ÇDO INFORMACION TJETËR QË KA LIDHJE ME NEVOJAT E VIKTIMËS:</b></p>

<sup>17</sup> Kjo nuk është listë shteruese e nevojave të viktimës, ajo shërben për të orientuar KVDHF dhe anëtarët e tjerë të ETN gjatë procesit të vlerësimit të nevojave emergjente dhe jo emergjente të viktimës.



## **ANEKS 6: MODEL PLANI I NDIHMËS INDIVIDUALE PËR RASTET E MENAXHUARA NGA MKR**

Plani i ndihmës individuale hartohet për çdo rast që mbështetet nga MKR dhe duhet të bazohet në nevojat individuale të rastit siç vlerësohen nga ETN duke përfshirë fushat si siguria, akomodimi afatgjatë, problemet ligjore, punësimi, mbështetja psiko-sociale, marrëdhëniet familjare, si dhe arsimimi e formimi profesional. Plani i ndihmës individuale formulohet në atë mënyrë që t'u korrespondojë me lehtësi nevojave të identifikuar gjatë procesit të vlerësimit. Një rast mund të ketë nevojë apo të dëshirojë ndihmë pak a shumë në secilën prej këtyre fushave të cituara më sipër, ose vetëm në disa prej tyre. Nëse nuk ka nevojë për ndihmë në një fushë të veçantë ose nëse ndihma e kërkuar në një fushë të caktuar nuk mund t'i jepet gjatë kohës që rasti ndiqet nga MKR përkatëse, atëherë në planin e ndihmës duhet të përfshihet vetëm një shpjegim i shkurtër mbi arësyen përse veprohet në këtë mënyrë. Në planin e ndihmës individuale sugjerohet të përfshihet e detajuar vetëm ndihma që do t'i jepet rastit gjatë kohës që menaxhohet nga anëtarët e MKR përkatëse.

### **Shpjegim i shkurtër i termave të përfshira në plan:**

**Objektivi:** ka lidhje me nevojat e identifikuar për ri-integrimin e rastit të dhunuar. Për shembull, për të lehtësuar ri-integrimin e rastit, ju dëshironi dhe keni hapësirë që ta trajtoni rastin deri në ofrimin e një mundësie për punësim. Kjo do të përbënte dhe objektivin e planit individual të ndihmës. **KUJDES:** Mos përfshini objektiva të shumëfishta në një rresht. Formuloni objektivat duke u bazuar në rezultate të dëshiruara të matshme dhe të arritshme.

**Veprime / Aktivitete:** nënkuptojnë tërësinë e hapave (mbështetjes së ofruar) që nevojiten për të përmbushur objektivat. Përsëri, mos përfshini veprime të shumëfishta në një rresht. Formuloni veprimet në një mënyrë sa më të qartë, duke pasur në konsideratë të gjitha hapat që duhet të ndiqen për ta konsideruar një veprim/aktivitet të realizuar. Gjithashtu mos harroni të caktoni edhe cili (institucion/individ) do të jetë përgjegjës për zbatimin e hapave përbërës të këtij veprimi. Për shembull, për punësimin e rastit, disa nga hapat mund të jenë a) Referimi tek Zyrat e Punës – përgjegjës/e KVDHF; b) Regjistrimi i rastit si punëkërkuar/e i/e papunë dhe identifikimi i mundësive bazuar në shkollimin e formimit profesional të tij/saj – përgjegjës/e Zyra Vendore e Punësimit; c) Regjistrimi i rastit në një kurs të formimit profesional – përgjegjës/e Zyra Vendore e Punësimit, d) Negocimi me punëmarrës që kërkojnë të punësojnë punonjës me karakteristikat e rastit që po menaxhohet – përgjegjës/e Zyra Vendore e Punësimit, etj.

**Institucioni/Personi përgjegjës:** nënkupton përcatimin e përgjegjësisë për realizimin e hapave të caktuar tek një institucion kryesor dhe më konkretisht tek përfaqësuesi/ja i këtij institucioni që është në cilësinë e antarit të ETN-së së MKR-së në Bashkinë përkatëse. Për shembull, këtu mund të flasim për a) Bashkia/Koordinatori/ja Vendor/e kundër Dhunës në Familje, b) Zyra Vendore e Punësimit dhe punonjësja përkatëse antare e ETN-së, c) vetë rasti që po menaxhohet, etj.

**Data për shqyrtim/vlerësim:** duhet të jetë një datë e arsyeshme për të shqyrtuar progresin. Çdo veprim mund të ketë një datë të ndryshme në varësi të asaj që është e arsyeshme. Afati duhet të japë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar progresin por nuk duhet të jetë aq i vonuar sa të humbet momenti.

**Treguesi i Suksesit:** duhet të jetë i qartë dhe i matshëm dhe të përshkruajë progresin e adresimit të nevojave për rastin përmes mbështetjes së ofruar bazuar në nevojat e vlerësuara. Në planin individual të ndihmës mund të përfshihen një tërësi treguesish që dokumentojnë progresin drejt arritjes së objektivave më të ndërlikuar. Në shembullin më sipër, një tregues i suksesit mund të jetë a) certifikimi në profesionin për të cilin u ndoq kursi i formimit profesional, ose b) punësimi i rastit, etj.



## SIGURIA

<b>Objektivi (Nevojat e identifikuara)</b>	<b>Veprimet / Aktivitetet (Mbështetja e ofruar)</b>	<b>Institucioni / Personi Përgjegjës</b>	<b>Data e shqyrtimit / vlerësimit</b>	<b>Treguesi i suksesit (Monitorimi i adresimit të nevojave për rastin e dhunuar)</b>

## AKOMODIM AFAT-GJATË

<b>Objektivi (Nevojat e identifikuara)</b>	<b>Veprimet / Aktivitetet (Mbështetja e ofruar)</b>	<b>Institucioni / Personi Përgjegjës</b>	<b>Data e shqyrtimit / vlerësimit</b>	<b>Treguesi i suksesit (Monitorimi i adresimit të nevojave për rastin e dhunuar)</b>

## SHËRBIMET LIGJORE

<b>Objektivi (Nevojat e identifikuara)</b>	<b>Veprimet / Aktivitetet (Mbështetja e ofruar)</b>	<b>Institucioni /Personi Përgjegjës</b>	<b>Data e shqyrtimit / vlerësimit</b>	<b>Treguesi i suksesit (Monitorimi i adresimit të nevojave për rastin e dhunuar)</b>

## SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Ky Protokoll është përgatitur me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T”i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë.





<b>Objektivi (Nevojat e identifikuara)</b>	<b>Veprimet / Aktivitetet (Mbështetja e ofruar)</b>	<b>Institucioni / Personi Përgjegjës</b>	<b>Data e shqyrtimit / vlerësimit</b>	<b>Treguesi i suksesit (Monitorimi i adresimit të nevojave për rastin e dhunuar)</b>

### FORMIMI PROFESIONAL / PUNËSIMI

<b>Objektivi (Nevojat e identifikuara)</b>	<b>Veprimet / Aktivitetet (Mbështetja e ofruar)</b>	<b>Institucioni / Personi Përgjegjës</b>	<b>Data e shqyrtimit / vlerësimit</b>	<b>Treguesi i suksesit (Monitorimi i adresimit të nevojave për rastin e dhunuar)</b>

### MBËSHTETJA PSIKO-SOCIALE

<b>Objektivi (Nevojat e identifikuara)</b>	<b>Veprimet / Aktivitetet (Mbështetja e ofruar)</b>	<b>Institucioni / Personi Përgjegjës</b>	<b>Data e shqyrtimit / vlerësimit</b>	<b>Treguesi i suksesit (Monitorimi i adresimit të nevojave për rastin e dhunuar)</b>

### MBËSHTETJA FAMILJARE

Ky Protokoll është përgatitur me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T”i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë.





Objektivi (Nevojat e identifikuara)	Veprimet / Aktivitetet (Mbështetja e ofruar)	Institucioni / Personi Përgjegjës	Data e shqyrtimit / vlerësimit	Treguesi i suksesit (Monitorimi i adresimit të nevojave për rastin e dhunuar)

### ARSHIMIMI

Objektivi (Nevojat e identifikuara)	Veprimet / Aktivitetet (Mbështetja e ofruar)	Institucioni / Personi Përgjegjës	Data e shqyrtimit / vlerësimit	Treguesi i suksesit (Monitorimi i adresimit të nevojave për rastin e dhunuar)

### Komente / Shënime:

Unë kam marrë pjesë në hartimin e këtij plani ndihme. Unë e kam shqyrtuar planin dhe jam dakord që me mundësitë e mia më të mira të marr përsipër përgjegjësitë për zbatimin e veprimeve të paraqitura këtu dhe të bëj çdo përpjekje për ta zbatuar këtë plan me sukses. Unë gjithashtu jam informuar dhe e kuptoj që mund të vendos ta ndërpres pjesëmarrjen time dhe të largohem nga kjo mbështetje, në çdo kohë.

Viktima

\_\_\_\_\_

Emri

Firma

Data

Ky Protokoll është përgatitur me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T”i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë.





Përfaqësuesi i MKR/KVDHF:

\_\_\_\_\_

Emri	Firma	Data
------	-------	------

Anëtarë të tjerë të MKR të përfshirë në menaxhimin e rastit (Specifiko institucionin dhe shtoni hapësirë sipas numrit të antarëve të përfshirë)

\_\_\_\_\_

Emri	Firma	Data
------	-------	------

Për fëmijët nën moshën 18 vjeç, kërkohet dhe firma e prindit ose kujdestarit ligjor. Nëse prindi apo kujdestari nuk ka mundësi të nënshkruajë formularin, këtu duhet të bashkëngjitet dokumentacioni që shpjegon arsyet.

Prindi / Kujdestari i viktimës së mitur:

\_\_\_\_\_

Emri	Firma	Data
------	-------	------

Ky Protokoll është përgatitur me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T”i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë.





## ANEKS 7: FORMULAR TIP PËR REFERIMIN E RASTEVE NDËRMJET ANTARËVE TË MKR

Rasti është:

- Paraqitur
- Identifikuar
- Referuar nga
- \_\_\_\_\_ në institucionin \_\_\_\_\_ në dt. \_\_\_\_\_

Në këtë institucion janë identifikuar nevojat e rastit si në vijim:

---

---

Për të lehtësuar procesin e ndjekjes së rastit po ju bashkangjijm dokumentat mbështetëse që disponohen nga institucioni ynë me informacion për rastin si në vijim: (Kliko/shto dokumenta të tjera të disponueshme mbi rastin që po referohet)

- Formulari kontakti/vlerësimi
- Përshkrim i mbështetjes së ofruar
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

Unë i/e nënshkruari/a, si një përfaqësues/e i/e institucionit ..... jam dakord me përdorimin e këtyre dokumentave vetëm për ofrimin e ndihmës së nevojshme për rastin në fjalë. Institucioni do të ruajë konfidencialitetin në lidhje me viktimën dhe informacionin e saj personal. Ne nuk do t'i ndajmë këto dokumenta apo informacionin që ato përmbajnë me asnjë person, pa pëlqimin me shkrim të dhënë nga vetë viktima (ose kujdestari ligjor, nëse është i/e mitur):

Dokumentat i dorëzohen përfaqësuesit/es së institucionit ku po referohet rasti \_\_\_\_\_ (emri i institucionit që merr përsipër ndihmën kryesore për rastin).

Përfaqësues i institucionit Referues:

Përfaqësues i institucionit Pritës

Emri

Emri

Firma / Data

Firma / Data

Emri i Institucionit

Emri i Institucionit



**ANEKS 8:  
MODEL I RAPORTIT PERIODIK TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË URDHËRIT  
TË MBROJTJES**

LOGO E BASHKISË  
BASHKIA \_\_\_\_\_  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE  
KOORDINATOR/E VENDOR/E PËR MENAXHIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË  
FAMILJE (DHF)

KONTAKTE

Data e Raportit.....

**RAPORT PERIODIK I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË URDHËRIT TË  
MBROJTJES  
të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor .....  
Nr....., Datë.....**

Raporti periodik i monitorimit të zbatimit të Urdhërit të Mbrojtjes për rastet e dhunës në familje përgatitet nga Koordinator/ja Vendor/e kundër Dhunës në Familje (KVDHF) çdo 60 ditë, sipas parashikimeve ligjore (Ligji Nr.9696/2006 “Për masat ndaj dhunës në mardhëniet familjare”, i ndryshuar) dhe i vihet në dispozicion strukturave të policisë së shtetit në Njësinë e Vetëqeverisjes vendore ku kryhet monitorimi. Qëllimi i këtij raporti monitorimi është evidentimi i nivelit të zbatueshmërisë së masave të parashikuara në urdhërin e mbrojtjes, identifikimi i rreziqeve të mundshme me qëllim parandalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm të dhunës së ushtruar mbi personin për të cilin është parashikuar mbrojtja me urdhërin përkatës të mbrojtjes, si dhe marrja e masave në rastet e shkeljes nga ana e dhunuesit/es të masave të parashikuara në UM, sipas parashikimeve ligjore. Raporti periodik përmbledh konkluzione dhe rekomandime të bazuara në takimet, vizitat apo komunikimin me telefon, e-mail, etj., me palët, përgjatë gjithë periudhës 60 ditore. Një format i tillë plotësohet çdo 60 ditë, deri në përfundim të kohëzgjatjes së UM.

**TË DHËNA MBI RAPORTIN**

Përgatitur nga:	Znj/Z. _____ Koordinator/e Vendor/e kundër Dhunës në Familje / Punonjëse Sociale e DSHS (Në mungesë të KVDHF)
Miratuar nga:	Z/Znj. _____ Përgjegjës/e ose Drejtor/e i/e Shërbimeve Sociale në Bashki
Vendndodhja:	Bashkia: _____
Periudha Kohore që mbulon raportin:	___/___/___ - ___/___/___
UM i monitoruar:	Vendimi Nr. _____ Dt ___/___/___
Personi i mbrojtur:	_____ (plotëso Emër mbiemër)
Kodi i rastit:	_____ (plotëso Kodi i rastit nga sistemi REVALB)

Ky Protokoll është përgatitur me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T” i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë.

Periudha e vlefshmërisë së UM	___/___/___ - ___/___/___
Objektivat e raportit:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të verifikojë zbatueshmërinë e urdhërit të mbrojtjes në territorin e Bashkisë _____</li> <li>- Të identifikojë problematikat në zbatimin e masave të dhëna në urdhërin e mbrojtjes;</li> <li>- Të identifikojë situatat që përbëjnë shkelje të masave të UM nga dhunuesi, si dhe marrjen e masave përkatëse sipas parashikimeve ligjore.</li> </ul>
Metodat e përdorura për përgatitjen e raportit	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Vizita në banesë;</li> <li>Intervistë me viktimën/dhunuesin/dëshmitarë/familjarë</li> <li>-Telefonata me viktimën dhe/ose të afërm të saj;</li> <li>-Komunikim me viktimën ose të afërm të saj me skype ;</li> <li>-Komunikim me viktimën ose të afërm të saj me mjete të tjera komunikimi</li> </ul> <p>_____</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Të dhëna nga institucionet (raport i NJMF/PMF-së; raport i shërbimit psiko-social në shkolla; përmbarimi, proces verbal i mbledhjes së ETN-së, etj.)</li> </ul>

## HYRJE

(Plotësoni një – dy paragrafë përmbledhës ku të përfshini qëllimin e raportit, përshkrimin e procesit të mbledhjes së të dhënave, anëtarët e ETN-së të MKR-së në bashkinë tuaj, me të cilët keni bashkëpunuar për mbledhjen e të dhënave dhe përgatitjen e raportit të monitorimit, etj. Në rast të vizitave në shtëpi, apo të takimeve me viktimën në ambjentet e Bashkisë ose kudo tjetër, apo në rast të komunikimeve me telefon apo me mjete të tjera komunikimi, jepni të përmbledhur në formë tabelore datën, vendin dhe kohëzgjatjen e takimit/komunikimit si dhe të dhënat e personit tjetër që mund të ketë qenë i pranishëm në këtë takim/komunikim së bashku me ju.

Nr	Përshkrimi i veprimit (vizitë në shtëpi / takim në zyrë/ komunikim me telefon/Skype, etj)	Data	Vendi	Ora	Kohëzgjatja	Personat e pranishëm

## PËRSHKRIMI/ANALIZIMI I SITUATËS SË ZBATIMIT TË UM NË TERRITOR

Në këtë seksion bëhet një përshkrim i informacionit mbi UM, kohëzgjatjen, masat e dhëna dhe zbatueshmërinë e masave dhe problematikat në lidhje me zbatimin e masave nëse rezultojnë, etj.



## SFIDAT E NDESHURA NË ZBATIMIN E UM

Në këtë seksion paraqiten shkurtimisht me pika sfidat<sup>18</sup> e ndeshura në zbatueshmërinë e UM duke i ilustruar dhe me shembuj.

## KONKLUZIONE

Në këtë seksion paraqiten konkluzionet/gjetjet kryesore nga monitorimi si edhe nevojat për t'u adresuar më tej, siç evidentohen gjatë procesit të monitorimit. KVDHF për të përcaktuar nevojat mund t'i referohet në mënyrë të veçantë faktorëve nga vleresimi i rrishtit kur viktima është cilësuar në rrezik të lartë/mesëm/të ulët nëse ato vazhdojnë të jenë të njëjtët, janë përshkallëzuar më shumë apo minimizuar.

## REKOMANDIME

Në këtë seksion parashtrihen në formë rekomandimesh të gjitha nevojat e identifikuar gjatë monitorimit të zbatueshmërisë së UM si dhe institucionet përgjegjëse që duhet të angazhohen më tej, për të mundësuar zbatueshmërinë e plotë të masave të parashikuara në UM.

<b>ÇËSHTJA/NEVOJA IDENTIFIKUAR</b>	<b>E</b> <b>VEPRIME PËR T'U NDËRMARRË (duke specifikuar dhe institucionin përgjegjës të MKR)</b>
<p>Masat e përfshira në UM janë zbatuar.</p> <p>Rezultojnë probleme që kërkojnë angazhim institucional në lidhje me zbatimin e masave të përfshira në UM. P.sh vështirësi emocionale gjatë zbatimit të masës për kufizimin ose ndalimin e takimeve të dhunuesit/es me fëmijët .</p> <p>Rezultojnë veprime të dhunuesit në kundërshtim me vendimin e gjykatës për lëshimin e UM. Dhunuesi kontakton/kërcënon viktimën rregullisht nëpërmjet xxxx, edhe pse ka një masë në vendim që e urdhëron të mos kërcënojë viktimën;</p>	<p>Vazhdon monitorimi i zbatimit të UM nga institucionet përgjegjëse gjatë gjithë periudhës që UM është në fuqi.</p> <p>DSHS/ZSHS bashkëpunon me Zyrën e Përmbartimit dhe policinë për zbatimin e masave të UM. Zbatimi i kësaj mase kërkon angazhimin edhe të aktorëve të tjerë si psikologë, punonjës social, etj.</p> <p>-Informohet viktima se dhunuesi në këtë rast është duke kryer veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës për lëshimin e UM dhe se kjo përbën një kundravajtje penale parashikuar nga neni 321 i KP për të cilën viktima duhet të denoncojë menjëherë rastin në polici. Kur KVDHF merr dijeni për shkeljen e UM, Raporti i monitorimit të zbatimit të UM i paraqitet prej saj strukturave të policisë menjëherë, pa pritur të plotësohet afati prej 60 ditësh. KVDHF thërret edhe mbledhjen e ETN, duke e ndarë këtë informacion me</p>

<sup>18</sup> Këtu mund të përshkruhen si sfida vështirësi në zbatimin e një mase të caktuar të parashikuar nga gjykata, psh kur është vendosur që viktima dhe dhunuesi t'i rrinë larg njëri tjetrit ndërkohë që ndajnë të njëjtën shtëpi. Ky Protokoll është përgatitur me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "T'i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri", financuar nga Qeveria e Suedisë.

	të gjithë anëtarët me qëllim marrjen e masave të koordinuara.
--	---

### **KOMENTE TË TJERA**

Në këtë seksion Koordinator/ja Vendor/e kundër Dhunës në Familje mund të shtojë informacione që janë të rëndësishme për t'u përmendur, përtej zbatueshmërisë së UM por që lidhen me adresimin e DHF, etj.